



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.223, datë 29.06.2021

PËR FILLIMIN E VERIFIKIMIT TË KANDIDATËVE PËR PLOTËSIMIN E KUSHTEVE LIGJORE TË KANDIDIMIT PËR PROCEDURËN E TRANSFERIMIT NËPËRMJET LËVIZJES PARALELE PËR VENDET VAKANTE NË PROKURORITË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 43 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të Ligjit nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 90 të Kodit të Procedurave Administrative, në nenin 15 pika 1 të Rregullores “Për transferimin e prokurorëve nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele” miratuar me Vendimin nr.261, datë 17.11.2020 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si dhe në relacionin shpjegues të përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

1. Fillimin e verifikimit të kandidatëve që plotësojnë kushtet ligjore të kandidimit për procedurën e transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele si më poshtë :

Nr.	Emër Mbiemër i Kandidatit	Zyra e prokurorisë ku kandidon
1	Adnan Hoxha	Prokuroria pranë Gjykatës të Shkallës së Parë Berat
2	Ajola Prenci	Prokuroria pranë Gjykatës të Shkallës së Parë Lezhë
4	Elidon Hysenaj	Prokuroria pranë Gjykatës të Shkallës së Parë Berat dhe Lezhë
5	Ledion Tema	Prokuroria pranë Gjykatës të Shkallës së Parë Lezhë
6	Urim Buci	Prokuroria pranë Gjykatës të Shkallës së Parë Lezhë

2. Përfundimin e procedurës së transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele në prokuroritë ku nuk ka kandidatë të kualifikuar si më poshtë :



- a) Pozicioni vakant në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së parë Dibër shpallur me vendimin nr.186, datë 09.06.2021;
- b) Pozicioni vakant në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së parë Gjirokastrë shpallur me vendimin nr.187, datë 09.06.2021;
- c) Pozicioni vakant në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së parë Kukës shpallur me vendimin nr.188, datë 09.06.2021;
- d) Pozicioni vakant në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së parë Sarandë shpallur me vendimin nr.190, datë 09.06.2021;
- e) Pozicioni vakant në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së parë Tropojë shpallur me vendimin nr.191, datë 09.06.2021;

3. Caktimin me short të relatorëve për procedurën e transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele për pozicionet, si më poshtë:

- Pozicion vakant nr.1 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së parë Berat shpallur me vendimin nr.184, datë 09.06.2021, caktohet relator Bujar Sheshi;
- Pozicion vakant nr.2 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së parë Berat shpallur me vendimin nr.185, datë 09.06.2021, caktohet relator Eloida Goxhi;
- Pozicioni vakant në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së parë Lezhë shpallur me vendimin nr.189, datë 09.06.2021, caktohet relator Alfred Balla;

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



**KRYETAR
GENT IBRAHIMI**

**ZV/KRYETAR
ALFRED BALLA**

**ANËTAR
KOSTAQ BELURI**

**ANËTAR
BUJAR SHESHI**

**ANËTAR
NURIHAN SEITI**

**ANËTAR
ELOIDA GOXHI**

**ANËTAR
ESMERALDA KESHI**

**ANËTAR
MOISI DUDA**

**ANËTAR
VATË STAKA**

**ANËTAR
SANDËR BECI**

**ANËTAR
TARTAR BAZAJ**